

Shaniko Allajbeu(1989-).Lektore në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali"www.univlora.edu.al)në Vlorë, Shqipëri dhe bashkëthemeluese e Akademisë së të Rinjve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (07 qershor 2017).Ka kryer shkollën tetëvjeçare (shkolla 8-vjeçare Peshtan dhe "Naim Frashëri", Tiranë, 2003);të mesme (gjimnazi "Arben Broci", 2007) në Tiranë. Mbaroi studimet universitare (bachelor në Kimi) në Universitetin e Tiranës (2010), në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega kimi e përgjithshme dhe studimet pasuniversitare, master i shkencave në kimi, po pranë këtij Universiteti në departamentin e kimisë, Seksioni i Kimisë Analitike (2012). Mikroteza e saj është një hap fillestar drejt kërkimit shkencor dhe lidhet me analizën kimike dhe metodat instrumentale të identifikimit të strukturës së lëndës ku ka bërë një studim të gjendjes mjedisore të gjirit të Vlorës nëpërmjet parametrave kimiko-fizikë të tij. Mbas vitit 2012 filloi kërkimet shkencore të thelluara, u regjistrua në shkollën e doktoratës në drejtimin *analiza kimike e lëndës e mjedisit*, në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dhe u bëanëtare e projektit ndërkombëtar "*ICP Vegetation*"(<http://icpvegetation.ceh.ac.uk/index.html>). Në bazë të shkollës së doktoraturës ajo vazhdoi kërkimet shkencore në fushën e biomonitorimit tëndotjes sëajrit nën udhëheqjen e prof. dr. Pranvera Lazo,ku pjesën eksperimentale të temës së disertacionit e kreunë Dubna, Rusi nën udhëheqjen e prof. dr. Marina Frontasyeva ([Joint Institute for Nuclear Research në Dubna, Rusi, www.jinr.ru](http://www.jinr.ru)) në periudhën janar–korrik, 2015. Më tetor 2015 u emërua pedagoge në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali", Fakulteti i Shkencave Teknike, ku krahas mësimdhënies përfundoi dhe studimet e doktoraturës dhe mori titullin "Doktor i shkencave" (10 maj 2017). Aktualisht vazhdon të punojnë në Universitetin e Vlorës.

Shaniko Allajbeu ka publikuar 3 (tre) artikuj shkencorë, ku 2 (dy) nga të cilët në revista ndërkombëtare me faktor impakti *Thomson* mbi 2. Ajoka marrë pjesë në 8 konferenca ndërkombëtare, 2 nga të cilat me *proceeding*, dhe në një konferencë kombëtare,gjithashtu është pjesë e raportit vjetor të *ICP Vegetation*për vitin 2015/2016 (<http://icpvegetation.ceh.ac.uk/publications/annual.html>).